

Sistemi ushqimor i Kosovës: Qëndrueshmëria e tij dhe politikat që mungojnë



Autorët:

Dardan Abazi

Dora Musa

Redaktuar nga:

Burim Ejupi

Copyright© 2021. **INDEP** dhe **Konrad-Adenauer-Stiftung**

Ky botim u mbështet nga Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS). Pikëpamjet e shprehura nuk pasqyrojnë detyrimisht pikëpamjet e Konrad-Adenauer-Stiftung.

Ky botim i i Konrad-Adenauer-Stiftung është menduar vetëm për qëllime informacioni. Ai nuk mund të përdoret nga partitë politike ose nga fushatat ose mbështetësit e zgjedhjeve për qëllime të reklamimit në zgjedhje. Kjo vlen për zgjedhjet federale, shtetërore dhe lokale, si dhe zgjedhjet për Parlamentin Evropian.

Ky publikim është shkruar në gjuhën angleze, andaj për çdo paqartësi në këtë version të përkthyer dhe përshtatur, konsultohuni me versionin origjinal "**Kosovo's Food System: Its Sustainability and Missing Policies**".

Përmbajtja

1. Hyrje	5
2. Metodologjia	10
3. Problemet dhe sfidat në sistemin ushqimor në Kosovë dhe kategorizimi i tyre në aspektin social, ekonomik dhe mjedisor	11
4. Politikat dhe Praktikrat e Sistemeve Ushqimore në Kosovë	12
Konkluzione dhe Rekomandime	14

Shkurtesat

Agjencia e Statistikave të Kosovës - **ASK**

Ballkani Perëndimor - **BP**

Bruto Produkti Vendor - **BPV**

Kombet e Bashkuara - **KB**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - **MBPZHR**

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - **OZHQ**

Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë - **UNKT**

1. Hyrje

Konsumimi i përditshëm i shumë artikujve ushqimorë, konkretisht marrja e lëndëve ushqyese, e mbështetin funksionimin e organizmit. Në kultura të ndryshme, ushqimi dihet gjithashtu se i mbledh njerëzit rreth një tavoline të vetme si një mjet për ndërveprim shoqëror. Përveç të qenit një domosdoshmëri dhe një mjet për ndërveprim social, ushqimi është bërë gjithashtu një burim i të ardhurave për shumë anëtarë të komuniteteve në viset urbane dhe rurale.

Por derisa këta artikuj ushqimorë të na shërbehen për konsum, ato i nënshtrohen një sistemi kompleks të referuar si sistemi ushqimor. Një sistem ushqimor përfshinë *“zinxhirët e aktiviteteve të tregut dhe jo të tregut dhe akterët që e lidhin prodhimin e ushqimit, grumbullimin, transportin dhe ruajtjen, përpunimin dhe furnizimin, shpërndarjen, përgatitjen dhe konsumin”*¹. Megjithatë, sistemet ushqimore shkojnë përtej këtyre aktiviteteve, si menaxhimi i mbetjeve ushqimore dhe i humbjes së ushqimit, ambalazhimi, plehrat, etj.² Të gjitha këto aktivitete dhe akterë që ndërveprojnë me njëri-tjetrin krijojnë një sistem shumë kompleks i cili në shumicën e rasteve (siç vërehet në mbarë botën) nuk është i qëndrueshëm. Pra, sfida e madhe e dekadës së fundit është se si mund t'i transformojmë sistemet ushqimore konvencionale në ato që janë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Kjo sfidë është e pranishme edhe në Kosovë. Sistemi ushqimor përballet me shumë pengesa, si mungesa e monitorimit të prodhimit të ushqimit, artikuj ushqimor të përpunuar së tepërmi që nuk promovojnë ndonjë dietë të shëndetshme dhe ushqyese, menaxhim i dobët i mbeturinave ushqimore,

për të përmendur disa prej tyre. Kjo shkakton probleme në 3 dimensione, në atë social, ekonomik dhe mjedisor. Prodhimi dhe konsumi i qëndrueshëm i ushqimit, krahas zhvillimit të viseve rurale dhe fermerëve, parashihen edhe në marrëveshjet dhe deklaratat rajonale për Ballkanin Perëndimor, ku përfshihet edhe Kosova.

Një nga këto marrëveshje është Deklarata e Sofjes, e nënshkruar në nëntor 2020 nga liderët e rajonit, ku së bashku u angazhuan për të punuar drejt një mjedis pa karbon, të pastër dhe të gjelbër në BP deri në vitin 2050. Sipas Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, transformimi i praktikave bujqësore të aplikuara në BP luan një rol të rëndësishëm, ashtu si nevoja për tranzicion energjetik, largim të ndotjes nga ajri, uji dhe toka, mbrojtje të biodiversitetit dhe promovim të ekonomisë qarkore.

Sipas komponentës së katërt të kësaj marrëveshjeje, përkatësisht *Bujqësi dhe prodhim ushqimor i qëndrueshëm*, Kosova është zotuar për përafrimin e sektorëve të saj të agrikulturës dhe prodhimit primar (si bujqësia, prerja e druve dhe mihjet) me standardet e BE-së, duke rritur kontrollet sanitare në zinxhirin ushqimor, për të përmirësuar infrastrukturën e cilësisë së ushqimit, për të promovuar qëndrueshmërinë mjedisore në bujqësi (përmes praktikave organike), trajtimin e duhur të mbetjeve ushqimore dhe inkurajimin e zhvillimit të qëndrueshëm në viset rurale.³ Nëse deri në vitin 2050, Kosova arrin objektivat e përcaktuara dhe të dakorduara në këto afate, përfitimet do të jenë të mëdha, si rrjedhojë progresi është më i shpejtë drejt integritimit në BE, përfundimi i kapitujve të Integritimit Evropian, nuk ka tatim të karbonit për produktet e eksportuara në gjithë territorin evropian dhe në përgjithësi, një mjedis më të gjelbër, më të sigurt dhe më të pastër për qytetarët.

1 Sandrine Dury, Pauline Bendjebbar, Étienne Hainzelin, Thierry Giordano dhe Nicolas Bricas (Eds). "Sistemet ushqimore në rrezik - Trendet dhe sfidat e reja". (2019). Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Kërkime dhe Agronomi për Zhvillim dhe Komisioni Evropian. f. 16. https://www.google.com/books/edition/Food_systems_at_risk/jla4DwAAQ-BAJ?hl=en&gbpv=0

2 Po aty.

3 Komisioni i BE-së. (2020). 'Deklarata e Sofjes për agjendën e gjelbër për Ballkanin Perëndimor'. f. 4. <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2021/02/Leaders-Declaration-on-the-Green-Agenda-for-the-WB.pdf>

Përveç këtyre, kalimi në sisteme të qëndrueshme ushqimore është në përputhje edhe me një kornizë tjetër, që janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQ), të cilat promovojnë dhënjen fund të urisë, arritjen e sigurisë ushqimore dhe përmirësojnë marrjen e lëndëve ushqyese dhe dietat.⁴ Nëse fillimisht shumica do të besonte se vetëm disa OZHQ lidhen me sistemet ushqimore, ndodh që të 17 OZHQ-të të lidhen me të. Me kalimin e sistemeve ushqimore konvencionale

në ato të qëndrueshme, objektivat e vendosura nga 17 OZHQ-të do të shënojnë jashtëzakonisht përparim, dhe si rrjedhojë krijim të vendeve të reja të punës, përmirësim të qasjes në ushqim, rritje të sigurisë ushqimore dhe promovim i një diete të shëndetshme dhe të ekuilibruar.⁵ Për përfitimet e detajuara të investimit dhe përparimit në OZHQ që reflektojnë në sistemin ushqimor janë paraqitur më poshtë.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)	Korrelacioni me sistemet ushqimore të qëndrueshme
Objektivi 1: Pa varfëri	Krijimi i vendeve të reja të punës, përmirësimi i qasjes në ushqim dhe përparimi drejt komuniteteve të shëndetshme
Objektivi 2: Zero uri	Adresimi i sfidave të zgjata të urisë, tronditjet (p.sh. shpërthimet e sëmundjeve, pandemitë, etj.) dhe efektet e ndryshimeve klimatike
Objektivi 3: Shëndeti i mirë dhe mirëqenia	Zgjatja e jetëgjatësisë, përmirësimi i marrjes së lëndëve ushqyese dhe arritja e shëndetit të mirë
Objektivi 4: Arsimi cilësor	Shëndeti dhe dieta e përmirësuar që i ndihmon nxënësit të kenë sukses
Objektivi 5: Barazia gjinore	Gra të fuqizuara dhe mënyra e jetesës e përmirësuar
Objektivi 6: Uji i pastër dhe shërbimet sanitare	Përdorimi racional i burimeve ujore, pakësimi i ndotjes dhe rritja e qasjes në të për qëllime të pijes për njerëzit në nevojë

4 Organizata për ushqim dhe bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO). "Koncepti dhe korniza e sistemeve të qëndrueshme të ushqimit". f. 1. <http://www.fao.org/3/ca2079en/CA2079EN.pdf>

5 KB "Food Systems Summit x SDGs". <https://www.un.org/en/food-systems-summit/sdgs>

Objektivi 7: Energji e përbalueshme dhe e pastër	Maksimizimi i burimeve të energjisë së pastër dhe të gjelbër që zvogëlojnë ndikimin e ndotjes në mjedis nga sektori i ushqimit dhe rritja e qasja në burime të gjelbra dhe të përbalueshme të energjisë
Objektivi 8: Punë e denjë dhe rritje ekonomike	Krijimi i vendeve të punës të denja dhe përkrahja e të ardhurave të qëndrueshme për të gjithë
Objektivi 9: Inovacioni dhe infrastruktura e industrisë	Shpërndarja e përfitimeve në masën më të madhe për njerëzit dhe planetin
Objektivi 10: Reduktimi i pabarazive	Reduktimi i varfërisë dhe sigurimi i punës dhe të ardhurave të denja
Objektivi 11: Komunitet dhe komunitetet e qëndrueshme	Ruajtja e fuqisë blerëse në viset urbane dhe sigurimi i ushqimit të mirë
Objektivi 12: Konsumi dhe prodhimi i përgjegjshëm	Reduktimi i mbetjeve ushqimore dhe fuqizimi i konsumatorëve për konsumin e ushqimit
Objektivi 13: Veprimi për klimën	Reduktimi i efekteve të ndryshimeve klimatike përmes reduktimit të emetimeve të gazërave serrë, si dioksidi i karbonit (CO ₂) dhe metani (CH ₄)
Objektivi 14: Jeta në ujë	Sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit dhe mbrojtjes së ekosistemeve të tyre
Objektivi 15: Jeta në tokë	Reduktimi i shpyllëzimit dhe sigurimi i ekosistemeve të shëndetshme
Objektivi 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta	Fuqizimi i institucioneve për problemet brenda sistemeve ushqimore me të cilat përballen familjet, komunitetet dhe kombet në përgjithësi
Objektivi 17: Partneritetet për objektiva	Shpërndarja e përfitimeve të përbashkëta në të gjithë globin

Tabela 1. Korrelacioni i OZHQ-ve me sistemet ushqimore të qëndrueshme

Në përgjithësi, ekonomia e Kosovës është goditur në mënyrë drastike nga pandemia, veçanërisht sektori i bujqësisë, i cili është një sektor që kontribuon shumë në Bruto produkti vendor (BPV). Në fund të vitit 2019, bujqësia ka kontribuar me 7.7% në rritjen e përgjithshme ekonomike të Kosovës.⁶ Me rrethanat e paprecedentë me pandeminë, padyshim se ky sektor në Kosovë u godit rëndë. Kjo mund të shihet nga zvogëlimi i kontributit të bujqësisë në BPV me 0.31% në fund të vitit 2020.⁷ Ndërsa sipas statistikave të vitit 2021, kjo rënie ishte edhe më e ndjeshme duke arritur në 0.90%.⁸ Duke pasur parasysh këtë, është e rëndësishme që Qeveria e Republikës së Kosovës të inkurajojë rimëkëmbjen e këtij sektori përmes hartimit të politikave të ndryshme në nivel lokal dhe qendror. Për më tepër, kjo paraqet një vull të madh për institucionet për të inkurajuar rimëkëmbjen që është e qëndrueshme në aspektin socio-ekonomik dhe mjedisor.

Me këtë rënie të kontributit në BPV, mund të thuhet se një numër i konsiderueshëm i të punësuarve në këtë sektor e kanë humbur punën. Kjo në mënyrë specifike pengon arritjen e OZHQ 1 dhe OZHQ 8 në sistemin ushqimor që synon krijimin e vendeve të reja të punës që sigurojnë të ardhura të qëndrueshme për familjet. Rrjedhimisht, të ardhurat e ulëta lidhen me marrjen e ulët të lëndëve ushqyese, duke kërcënuar kështu përmbushjen e OZHQ 1 dhe OZHQ 3. Amvisëritë me të ardhura të ulëta janë të prirura që të ushqehen me lëndë ushqyese me cilësi të ulët, kështu që synimi për të mbajtur komunitete të shëndetshme vihet në rrezik të lartë⁹.

Kjo kërcënon në mënyrë indirekte OZHQ 2, OZHQ 4, OZHQ 5 dhe OZHQ 10.

Nëse faktorët e lartpërmendur ndikojnë në OZHQ të caktuara në aspektin socio-ekonomik, pjesa tjetër e OZHQ-ve të tjera, përkatësisht OZHQ 6, OZHQ 7, OZHQ 9, OZHQ 11, OZHQ 12, OZHQ 13, OZHQ 14, OZHQ 15, lidhen me ndikimet në mjedis nga prodhimi dhe konsumi i ushqimit. Kosova njihet gjerësisht si ndër ndotësit më të mëdhenj të ajrit në BP. Sektori i bujqësisë në Kosovë mbetet ndër sektorët që emeton më së shumti CO₂¹⁰.

Në vitin 2019, 8% ose 706 mijë ton CO₂ ek. nga sasia totale e emetimit të gazërave serrë erdhi nga sektori i bujqësisë¹¹. Praktikrat që kontribuuan më së shumti në këtë sasi të emetimeve në 2019 përfshijnë:

- (1) Fermentimi enterik ose procesi digjestiv i kafshëve (67%),
- (2) Emetimet nga menaxhimi i plehut organik të kafshëve (10%), dhe
- (3) Emetimet nga menaxhimi i tokës (12%)¹².

Krahas ndotjes së ajrit, bujqësia intensive kontaminon edhe burimet e ujit në Kosovë duke qenë sektori i dytë më i madh që konsumon ujin për qëllime të ujitjes¹³. Sipas Agjencisë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AMMK), cilësia e burimeve ujore në Kosovë vazhdimisht po ndikohet nga përdorimi dhe shkarkimi i pesticideve dhe plehrave nga sektori i bujqësisë¹⁴. Fillimisht, burimet ujore nëntokësore

6 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2021). "Struktura e Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike Rish.2 Aktivitetet ekonomike, hisja e GDP sipas aktiviteteve dhe vitit". https://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/en/askdata/askdata_07%20National%20and%20government%20accounts__National%20accounts__Annual%20national%20accounts/gdp10.px/table/tableViewLayout1/?rxid=ad787284-363a-44a5-bb3d-0f067afa36b7

7 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2021). "Bruto Produkti Vendor TM4 2020". <https://ask.rks-gov.net/media/5956/bruto-produkti-anglisht-q4-2020.pdf>

8 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). (2021). "Bruto Produkti Vendor TM4 2020". <https://ask.rks-gov.net/media/6103/gross-domestic-product-gdp-of-the-expenditure-and-production-approach-q1-2021.pdf>

9 Simone A. French, Christy C. Tangney, Melissa M. Crane, Yamin Wang dhe Bradley M. Appelhans. (2019). "Cilësia e të ushqyerit e blerjeve të ushqimit ndryshon sipas të ardhurave

të amvisërisë: studimi SHoPPER". BMC Public Health. <https://bmcpublichealth.biomedcentral.com/track/pdf/10.1186/s12889-019-6546-2.pdf>

10 Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. (2021). "Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018-2019". f. 71. [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Shqip_WEB_\(ok\).pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Shqip_WEB_(ok).pdf)

11 Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. (2021). "Raport Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë 2014-2019". f. 17. [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raport_i_GHG_2014-2019_\(final_ueb_version\).pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raport_i_GHG_2014-2019_(final_ueb_version).pdf)

12 Po aty.

13 Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit. (2020). "Mjedi i Kosovës Raport i Treguesve Mjedisorë". f. 49. https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjedi_i_Kosov%C3%ABs_2020_Raport_i_treguesve_mjedisor%C3%AB_-_SHQIP.pdf

14 Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit. (2021). "Raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018-2019". f. 89. [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Shqip_WEB_\(ok\).pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Shqip_WEB_(ok).pdf)



kontaminohen përmes procesit të rrjedhjes nga tokat bujqësore e cila më pas përfundon duke ndotur burimet e ujit sipërfaqësor¹⁵. Kjo kërcënon shumë synimet e objektivave që lidhen me mbrojtjen e ekosistemeve, qoftë jetën në ujë dhe jetën në tokë, ashtu edhe ruajtjen e burimeve të pastra ujore.

Duke marrë parasysh të gjitha këto efekte në dimensionin socio-ekonomik dhe mjedisor, të imponuara nga praktikat bujqësore të kryera nga njerëzit, duhet të fillohet të rimendohet se si mund të riorganizohet sistemi ushqimor në Kosovë dhe të inkurajohet një tranzicion drejt një sistemi të qëndrueshëm ushqimor. Agroekologjia po e zëvendëson ngadalë perceptimin e bujqësisë tradicionale. Ky koncept i ri tregon një "qasje të integruar që zbaton njëkohësisht konceptet dhe parimet ekologjike dhe sociale në hartimin dhe menaxhimin e sistemeve të qëndrueshme të bujqësisë dhe ushqimit"¹⁶. Agroekologjia jep siguri më të lartë, emetime më të ulëta të CO₂, dhe në përgjithësi mbrojtje më të madhe dhe mjedis më të gjelbër.

Duke synuar promovimin e agro-ekologjisë dhe sistemeve të qëndrueshme ushqimore, Kombet e Bashkuara (KB) e organizuan për herë të parë Samitin e Sistemeve Ushqimore. Ky samit synon të ofrojë një mundësi globale për fuqizimin e të gjithë hisedarëve brenda sistemit ushqimor dhe vetë sistemit, për t'u rikuperuar nga pandemia dhe për të arritur 17 OZHQ-të e dakorduara deri në vitin 2030¹⁷. Përmes dialogut të drejtpërdrejtë dhe të pavarur të mbajtur në shumë shtete, Samiti synon tranzicionin e modeleve të prodhimit dhe konsumit, krahas perceptimit ndaj ushqimit. Në këto linja, Kosova tashmë ka marrë pjesë me një dialog të pavarur të mbajtur në fillim të korrikut 2021 dhe tashmë ka dorëzuar raportin pranë KB në kuadër të Samitit të Sistemeve Ushqimore 2021. Dialogu u organizua nga Instituti për Politika Zhvillimore (IN-DEP), dhe në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT). Dialogu mbledhi hisedarët e fushës, përkatësisht institucionet publike (niveli qendror dhe lokal), sektorin privat (si prodhuesit, komuniteti i biznesit, fermerët, etj.), organizatat ndërkombëtare, komunitetin e donatorëve, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, mediat dhe qytetarët/konsumatorët. Rezultatet e dialogut të pavarur të Kosovës mund të lexohen më tej në faqen e internetit të Samitit të KB-së për Sistemet Ushqimore.

15 Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit. (2020). "Mjedisi i Kosovës Raport i Treguesve Mjedorë". f. 42. https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Mjedisi_i_Kosov%C3%ABs_2020_Raport_i_treguesve_mjedor%C3%AB_-SHQIP.pdf

16 Organizata për ushqim dhe bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO). "Qendra e njohurive për agroekologji". par. 1. <http://www.fao.org/agroecology/overview/en/>

17 Kombet e Bashkuara (KB). "Samiti i Sistemeve Ushqimore 2021". par. 2. <https://www.un.org/en/food-systems-summit/summit>

2. Metodologjia

Sistemi i ushqimit në Kosovë ende ballafaqohet me sfida të shumta të cilat e largojnë atë nga kalimi në një sistem të qëndrueshëm që plotëson të gjitha dimensionet sociale, ekonomike dhe mjedisore. Për të kuptuar plotësisht sfidat e tilla, për këtë raport janë përdorur metoda kërkimore cilësore, përkatesisht hulumtimi në tavolinë dhe në fokus grupe.

Duke filluar me hulumtimin në tavolinë, kjo metodë kontribuoi në mbledhjen e të dhënave në shkallë globale, por edhe për sfondin e Kosovës në sistemin ushqimor. Në këtë proces u përcaktuan problemet, së bashku me kornizën ligjore dhe institucionale të sistemit ushqimor në Kosovë. Shqyrtimi i literaturës jep dëshmi dhe raste studimore të shteteve të tjera që kanë pasur sukses në tranzicionin e tyre të sistemeve ushqimore, e të cilat metoda mund të përshtaten edhe nga Kosova.

Përveç hulumtimit në tavolinë dhe shqyrtimit të literaturës, fokus grupet u mbajtën si pjesë e dialogut të pavarur të Kosovës ku të dyja anët e sistemeve ushqimore, prodhimi dhe konsumi, u trajtuan në detaje me pjesëmarrësit. Këto fokus grupe, përveç që ndihmuan në identifikimin e sfidave brenda sektorit, ndihmuan edhe në hartimin e zgjidhjeve dhe të rekomandimeve të cilat mund të aplikohen në Kosovë për ta nisur tranzicionin drejt një sistemi të qëndrueshëm ushqimor. Pjesëmarrësit u ndanë në 3 fokus grupe me temat e paraqitura si më poshtë:

1. Prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit
2. Konsumi i qëndrueshëm i ushqimit
3. Shfrytëzimi qarkor i burimeve natyrore

Diskutimet ishin afërsisht 1 orë dhe mbledhën më shumë se 10 pjesëmarrës për secilin grup. Pjesëmarrësit u udhëzuan në diskutim përmes pyetjeve gjysmë të strukturuar, me ç'rast diskutuan çështje të caktuara, identifikuan problemet brenda sistemit ushqimor në Kosovë dhe së bashku identifikuan zgjidhjet dhe rekomandimet. Gjetjet e 3 fokus grupeve u integruan në raportin e dorëzuar në Samitin e KB-së për Sistemet Ushqimore.

Sa i përket kufizimeve, hasëm disa prej tyre gjatë kryerjes së këtij punimi kërkimor. Në fillim, mungonin të dhënat për menaxhimin e mbetjeve; informatat të cilat duhet të publikohen nga autoritetet vendore. Këto të dhëna janë të kufizuara në numër pasi raportimi nuk bëhet periodikisht, prandaj duhej të bëhej një vlerësim i përafërt i të dhënave që mungonin, bazuar në atë që ishte në dispozicion dhe ishte publike. Kjo çon në supozimin e shifrave lidhur me gjenerimit aktual të mbetjeve dhe variabla të tjera që lidhen me këtë sektor. Edhe gjatë intervistave me hisedarët, gjasat janë që të mungojë një pasqyrë e qartë e situatës në terren e as nuk njihen mirë numrat dhe të dhënat për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Për më tepër, shumë nga të intervistuarit e identifikuar dhe të mundshëm nga niveli qendror dhe lokal, hezitonin dhe nuk donin të merrnin pjesë në intervistë, prandaj në kombinim me informatat në dispozicion të nxjerra nga hulumtimi në zyrë dhe nga takimet me disa nga hisedarët, punimi synon ta jepë një pasqyrë reale të këtij sektori në Kosovë.

Në Aneksin A mund të gjendet raporti i plotë i komenteve që u dorëzua nën Samitin e KB-së për Sistemet Ushqimore. Formulari përfshinë edhe disa nga diskutimet dhe gjetjet kryesore të fokus grupeve.

3. Problemet dhe sfidat në sistemin ushqimor në Kosovë dhe kategorizimi i tyre në aspektin social, ekonomik dhe mjedisor

Pjesa e katërt e punimit shpjegon më shumë se çka është një sistem ushqimor dhe cilët janë komponentët e tij, duke filluar nga rritja dhe kultivimi i produkteve, deri te përpunimi, paketimi, transportimi, konsumimi dhe asgjësimi i plotë i artikullit ushqimor. Duke marrë parasysh statistikën lokale, në këtë pjesë janë paraqitur edhe të dhënat më të fundit për popullsinë urbane dhe rurale, papunësinë, nivelin e kequshqyerjes, sëmundjet që lidhen me këtë të fundit siç është obeziteti etj., të cilat janë të lidhura ngushtë me sistemin ushqimor.

Fokusi i veçantë i këtij seksioni do të jetë përcaktimi i problemeve të sistemit ushqimor në Kosovë. Problemet e identifikuar do të trajtohen në 3 dimensione, sociale, ekonomike dhe mjedisore. Aspekti social lidhet më shumë me OZHQ 2 ku trajtohen çështjet e të ushqyerit dhe vlerave ushqyese të nevojshme për çdo individ, ndërsa aspekti ekonomik trajton çështjen e ndryshimeve apo instabilitetit të çmimeve për produktet bazë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, aspekti mjedisor, i cili lidhet me OZHQ 12, diskuton rëndësinë e ndryshimit të praktikave të prodhimit dhe konsumit, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve ushqimore dhe humbjen e ushqimit në përgjithësi.

Përveç kësaj, ky kapitull synon që ta trajtojë urbanizimin (përhapja urbane dhe migrimi i lartë i brendshëm) dhe se si modelet e të ushqyerit po transformohen në këtë kohë. Në këtë drejtim, kapitulli kërkon të vlerësojë se sa punë është duke u bërë drejt transformimit nga një sistem ushqimor tradicional në Kosovë drejt një sistemi kaq të qëndrueshëm.

4. Politikat dhe Praktikrat e Sistemeve Ushqimore në Kosovë


Përderisa kapitulli i mëparshëm definon problemet në sistemin ushqimor në Kosovë, ky kapitull synon të identifikojë zgjidhjet e këtyre problemeve. Për çdo problem të përcaktuar jepet zgjidhja konkrete. Për më tepër, ky kapitull ofron shembuj krahasues të shteteve të rajonit, por edhe shteteve tjera në botë, të cilat kanë adresuar probleme të ngjashme

dhe kanë bërë progres në transformimin e qëndrueshëm të sistemit të tyre ushqimor.

Në zinxhirin e sistemit ushqimor, prodhimtaria, procesimi, shpërndarja, tregu & qasja, konsumi dhe mbeturinat, ka një mori politikash dhe mungesash në sistemin tonë politik.



Cikli i ushqimit – korniza e opsioneve të politikave



Konkluzione dhe Rekomandime

Pjesa e parë e këtij kapitulli i tregon gjetjet e punimit. Por pjesa kryesore është ajo e rekomandimeve konkrete. Duke renditur zgjidhjet për secilin problem të identifikuar, ky kapitull paraqet rekomandimet të cilat u drejtohen institucioneve përgjegjëse dhe shërbejnë si mjet avokues për transformimin e sistemit ushqimor në Kosovë. Këto rekomandime mund të përfshijnë aspekte ligjore, fushata vetëdijesimi për të ndryshuar zgjedhjet si konsumatorë dhe sjelljen e tyre në konsum, inkurajimin e ndryshimit të dietës dhe të ushqyerit, trajtimin adekuat të mbetjeve ushqimore, etj.

Menaxhimi i të dhënave për tokat e degraduara dhe të konsumuara nuk është ende në nivelin e kërkuar. Kjo mungesë e të dhënave vjen si pasojë e një komunikimi jo konsistent ndërmjet komunitetit, institucioneve lokale dhe qendrore. Për të pasur një planifikim të duhur për përdorimin e tokës, si për prodhimet bujqësore, ndërtimore apo aktivitete ekonomike, duhet të kemi një databazë me të dhëna të sakta.

Duhet të ketë më shumë kontroll të cilësisë së artikujve ushqimorë, pasi kjo është një praktikë që i mungon Kosovës. Nevojitet zbatim i duhur i legjislacionit në fuqi dhe mekanizma më të mirë monitorues për tërë kornizën legjislative të sistemit ushqimor. Fermerët dhe prodhuesit duhet të jenë më të vetëdijshëm për rëndësinë e shërbimeve të konsulencës profesionale dhe programeve të trajnimit të ofruara në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre për praktikatat e qëndrueshme të prodhimit.

Gratë duhet të fuqizohen në pjesë të tjera të sistemit ushqimor, përkatësisht në menaxhim dhe vendim-marrje në biznes dhe ferma. Institucionet qendrore duhet të ofrojnë përkrahje financiare për fermerët lokal, veçanërisht gratë sipërmarrëse, në mënyrë që kamata në kredi të jetë më e përballueshme ose e ulur.

Duhet të rriten kapacitetet e inspektoratit në institucionet e nivelit qendror dhe lokal për të pasur më shumë kontroll të cilësisë së artikujve ushqimorë. Për më tepër, duhet të ketë koordinim më të mirë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe drejtorive komunale të bujqësisë. Duhet të ketë më shumë investime në sistemet e ujitjes dhe pastrimit të burimeve ujore.

Institucionet e nivelit qendror duhet të ndërthurin politikatat për ta promovuar bujqësinë tek të rinjtë dhe për ta dekurajuar migrimin. Analiza, mbledhja e të dhënave dhe raportimi i rregullt duhet të kryhen për shportën e ushqimit të konsumatorit në mënyrë që të merren njohuri për vlerat bazë ushqyese dhe të sigurohen politika të bazuara në dëshmi që e përkrahin sistemin e qëndrueshëm ushqimor.

Duhet të rriten kapacitetet e inspektoratit në institucionet e nivelit qendror dhe lokal për të pasur më shumë kontroll të cilësisë së artikujve ushqimorë. Për më tepër, duhet të ketë koordinim më të mirë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe drejtorive komunale të bujqësisë. Duhet të ketë më shumë investime në sistemet e ujitjes dhe pastrimit të burimeve ujore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me komunat duhet ta kryejë digjitalizimin e parcelave të tokës dhe të punojë në kategorizimin e tokave të cilat kontribuojnë në nevojën për madhësi më të madhe të parcelave të tokës. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duhet të krijojë skema përkrahëse për sistemet ngadalta të ushqimit, të cilat do të inkurajonin prodhuesit vendas në përvetësimin e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit, në ekonomizimin e zonës lokale dhe inkurajimin e qytetarëve drejt konsumit të artikujve ushqimorë të prodhuar në vend.

Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë duhet të krijojë një program të veçantë për ta përkrahur inovacionin në bujqësinë urbane, i cili do të kontribuonte në socializimin më të lartë brenda anëtarëve të komunitetit, promovimin e produkteve të gjelbra me intensitet të ulët të karbonit dhe përfshirjen e anëtarëve të komunitetit që kanë mbetur prapa.

Agro-ekologjia si koncept duhet të integrohet brenda kornizës së politikave dhe kurrikulave arsimore. Pesticidet organike duhet të marrin politika dhe stimuj financiarë nga institucionet e nivelit qendror. Standardizimi i etiketimit të ushqimit duhet të jetë prioritet për të përmirësuar të drejtat e konsumatorit, si dhe për të reduktuar mbetjet ushqimore dhe për të promovuar artikujt ushqimorë me intensitet të ulët të energjisë. Materialet edukative që promovojnë ushqimin e qëndrueshëm duhet të përfshihen në kurrikulën parashkollore si dhe në shkollën fillore dhe duhet të futet një program i veçantë trajnimi për mësimmshënësit.

Parimi “Ndotësi paguan” duhet të integrohet thellësisht në kornizën e politikave që mbulon politikat ndërinstitutionale. Të hyrat financiare që rrjedhin nga politikat parimore “Ndotësi paguan” duhet të trajtohen si të dedikuara për financimin e programeve që promovojnë në mënyrë specifike mbrojtjen e mjedisit dhe sistemin e qëndrueshëm të ushqimit.

Aneksi A: Formulari i pavarur zyrtar i përshtypjeve i Kosovës

FORMULAR ZYRTAR I PËRSHTYPJEVE



DATA E DIALOGUT	E martë, 13 korrik 2021 10:00 GMT +02:00
TITULLI I DIALOGUT	Transformimi i sistemit ushqimor të Kosovës: Mundësitë për ta nxitur prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm të ushqimit për t'u rikthyer më mirë nga COVID-19
THIRRUR NGA	Institutin për politikat zhvillimore (INDEP)
FAQJA E EVENTIT TË DIALOGUT	https://summitdialogues.org/dialogue/31394/
TIPI I DIALOGUT	I pavarur
FOKUSI GJEOGRAFIK	Nuk është shtet anëtar i KB

Rezultatet nga Dialogu i Samitit të Sistemeve Ushqimore do të jenë të dobishme në trasimin e rrugës drejt sistemeve të qëndrueshme ushqimore brenda lokalitetit në të cilin ato zhvillohen. Ato do të jenë një kontribut i çmueshëm në rrugët kombëtare dhe gjithashtu me interes për rrjedhat e ndryshme të punës që përgatiten për Samitin: Pistat e Veprimit, Grupet Shkencore dhe Kampionët si dhe për Dialogët tjerë.

1. PJESËMARRJA

NUMRI TOTAL I PJESËMARRËSVE

50

PJESËMARRJA SIPAS GRUPMOSHËS

0-18

6

19-30

35

31-50

9

51-65

66-80

80+

PJESËMARRJA SIPAS GJINISË

28

Mashkull

22

Femër

Nuk dua ta them ose Tjetër

NUMRI I PJESËMARRËSVE NË SECILIN SEKTOR

Bujqësi/kultura

4

Arsimi

Shëndeti

Peshku dhe akua-kultura

Komunikimi

4

Ushqyerja

Blegtoria

1

Përpunimi i ushqimit

14

Qeveria qendrore dhe lokale

Agro-pylltaria

Shitja me pakicë e ushqimeve, tregjet

Komunalet

Mjedisi dhe ekologjia

1

Industria ushqimore

2

Industriale

1 Tregti dhe komerc

1

Shërbimet Financiare

22

Tjetër

NUMRI I PJESËMARRËSVE NGA SECILI GRUP I HISEDARËVE

2 Ndërmarrje e vogël/e mesme/artizan

Punëtorë dhe sindikata

1 Biznes i madh kombëtar

Deputetë të parlamentit

Korporatë multinacionale

5 Autoritet lokal

Fermer në shkallë të vogël

9 Qeveri dhe institucion kombëtar

Fermer në shkallë të mesme

Komunitet regional ekonomik

Fermer në shkallë të vogël

5 Kombet e Bashkuara

7 Organizatë Lokale Jo-Qeveritare

1 Institucion Financiar Ndërkombëtar

Organizatë Jo-qeveritare Ndërkombëtare

4 Fondacion privat / Partneritet / Aleancë

Popullatë indigjene

1 Grup i konsumatorëve

4 Shkencë dhe akademi

11 Të tjera

2. PARIMET E ANGAZHIMIT

SI E ORGANIZOVE DIALOGUN ASHTU QË PARIMET INKORPOROHEN, PËRFORCOHEN DHE RRIEN?

Dialogu ynë inkorporoi plotësisht parimet e angazhimit në kuadër të dialogut të KB-së për sistemet e ushqimit. Meqenëse sistemet e ushqimit janë komplekse dhe mbulojnë të tre dimensionet kryesore (ekonomike, sociale dhe mjedisore), ne e kemi përvetësuar një qasje sistematike, ndërsektoriale për të mbledhur pikëpamjet dhe perspektivat e të gjithë pjesëmarrësve lidhur me sistemin ushqimor të Kosovës përmes grupeve/sesioneve të veçanta. Ngjarja mbledhi njerëz nga shumë sektorë për ta adresuar plotësisht kompleksitetin e sistemeve ushqimore dhe si duhet ta shikojmë këtë çështje në Kosovë nga më shumë se vetëm një kënd. Pjesëmarrësit u ftuan duke marrë parasysh sektorët, interesat, rolin dhe angazhimin e tyre me sistemin ushqimor të Kosovës. Dialogu u mbajt më 13 korrik, i organizuar nga INDEP, në partneritet me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe ekipin e KB-së në Kosovë. Objektivi i dialogut ishte:

- Promovimi dhe shkëmbimi i përvojave dhe njohurive praktike për të identifikuar sfidat e përbashkëta, prioritetet dhe rekomandimet e politikave për sistemin e qëndrueshëm të ushqimit
- Ndhima në koordinimin, nxitjen e njohurive dhe harmonizimin e përkrahjes nëpër sektorë të ndryshëm për iniciativa të drejtuara në nivel lokal dhe të zbatueshme për të avancuar transformimin e sistemeve ushqimore në Kosovë.
- Inkurajimi i masave konkrete dhe angazhimi aktiv nga të gjithë aktorët e shoqërisë për të kontribuar drejt sistemeve ushqimore më të qëndrueshme, inkluzive dhe reziliente.

Organizatorët përfituan nga udhëzimet e relaksuara kohët e fundit për tubimet publike për të organizuar një diskutim shumë të mirëpritur me prani fizike, megjithëse brenda udhëzimeve për COVID dhe me audiencë të përzgjedhur. Pjesëmarrësve iu dha mundësia që ta dëgjonin njëri-tjetrin. Ata u ndanë në tre grupe, duke mbuluar temat e (1) prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit, (2) konsumit të qëndrueshëm të ushqimit dhe (3) përdorimit qarkor të burimeve ushqimore. Diskutimet u bënë të mundur që t'i shikonin sfidat dhe fushat ku nevojiten hapat e ardhshëm në afat të shkurtër dhe afatgjatë. Përveç kësaj, transmetimi i drejtpërdrejtë në faqen e INDEP në Facebook hapi dialogun për një audiencë më të gjerë.

SI PASQYROI DIALOGU JUAJ NË ASPEKTET SPECIFIKE TË PARIMEVE?

Dialogu ynë përqafoi përfshirjen e shumë hisedarëve duke synuar pjesëmarrës nga një gamë e gjerë e përkatësisë, profileve dhe rajoneve në mbarë Kosovën. Mbi 50 pjesëmarrës që përfaqësojnë qeverinë, bizneset, organizatat, akademinë, shoqërinë civile, fermerët, pronarët e restoranteve si dhe studentë universitarë që përfaqësojnë gjeneratën e ardhshme të liderëve, u mbledhën së bashku për ta diskutuar statusin aktual të sistemit ushqimor të Kosovës nga perspektiva e mundësisë të ushqyerjes së sigurt, të qasshme dhe të shëndetshme, që e përkrahë ekonominë qarkore dhe shfrytëzimin më efikas të resurseve; dhe nxitë prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm në Kosovë. Janë bërë përpjekje të përbashkëta për të siguruar pjesëmarrjen e numrit të barabartë të grave dhe një numri përfaqësues të grupeve jo-shumicë. Në përgjithësi, dialogu përfshiu 3 grupe, të paraprirë nga fjalët kyçe nga Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Koordinatori i KB-së për Zhvillim, që përfshiu një prezantim të Samitit të KB-së për Sistemet Ushqimore 2021 dhe objektivat e dialogëve, si dhe një përmbledhje të shkurtër mbi statusin e sistemit ushqimor të Kosovës. Kjo u shoqërua me një ndërhyrje të shkurtër nga një specialist i sistemit ushqimor nga Zyra Rajonale e FAO-së për Evropën dhe Azinë Qendrore, i cili i prezantoi konceptet dhe parimet kryesore të një sistemi ushqimor dhe lidhjet në mes të sistemeve ushqimore dhe ekonomive tona, jetesës dhe mirëqenies. Tri temat tematike të diskutimit (• 1: prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit • 2: konsumi i qëndrueshëm i ushqimit • 3: përdorimi qarkor i burimeve ushqimore) u formuluan së bashku me një listë të pyetjeve të shkurtra dhe materiale mbështetëse/përgatitore, për të udhëhequr diskutimet dhe moderatorët në definimin e thirrjes për veprim/deklaratave që do të realizohen deri në vitin 2030. Në fund, dialogu u plotësua nga ekspertiza e Ekipit të KB-së për Kosovën dhe Ministrisë së Bujqësisë së Kosovës, për të siguruar se temat kryesore dhe rezultatet e diskutimeve do të ndihmojnë në adresimin e nevojave dhe prioritetëve të popullit të Kosovës, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin afatgjatë dhe prosperitetin e përbashkët në Kosovë.

A KENI KËSHILLA PËR ORGANIZATORËT TJERË TË DIALOGUT RRETH VLERËSIMIT TË PARIMEVE TË ANGAZHIMIT?

Rekomandojmë që formati dhe struktura e Dialogut të mundësojë që të gjithë hisedarët të marrin pjesë aktive në dialog dhe që zëri i tyre të dëgjohet dhe të përforcohet përmes diskutimeve. Ambienti jozyrtar i grupeve tona të ndara inkurajoi pjesëmarrësit që të përfshihen në diskutime të singërta dhe të hapura me homologët e tyre, të frymëzuar nga parimet thelbësore të ndershmërisë, respektit dhe mendjes së hapur. Së dyti, moderimi dhe prezantimi i të gjitha pistave të veprimit duhet të bëhet në një gjuhë të qartë, koncize, të kuptueshme dhe të përvetësohet lehtësisht nga të gjithë, dhe të lokalizohet/përshtatet me situatën e sistemit ushqimor në vend dhe sfidat kryesore me të cilat përballet vendi. Në fund, përzgjedhja e pjesëmarrësve duhet të mundësojë vizatimin e një pamje gjithëpërfshirëse e sfidave, rekomandimeve dhe mësimëve kryesore që lidhen me sistemin ushqimor në vend. Duke marrë parasysh që sistemet ushqimore janë komplekse, Dialogu duhet ta përdorë një qasje shumë-sektoriale dhe ndër-disiplinore për të sjellë së bashku njerëzit dhe hisedarët në të gjitha nivelet (p.sh. individual, organizativ, institucional; kombëtar, rajonal lokal, etj.) për ta parë këtë temë nga një lente përtej vetëm një këndi (p.sh. ekonomik, social, mjedisor).

3. METODA

Rezultatet e dialogut ndikohen nga metoda që përdoret.

A E KENI PËRDORUR TË NJËJTËN METODË SI REKOMANDOHET NGA MANUALI REFERENCAVE TË MBLEDHJES?

Po

Jo

4. FOKUSI DIALOGU DHE REZULTATET

FOKUSI MADHOR

Ne të gjithë duhet të punojmë së bashku për ta transformuar mënyrën se si Kosova prodhon, konsumon dhe mendon për ushqimin. Sistemi Ushqimor i Kosovës luan një rol qendror në sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe arritjen e Agjendës 2030 në Kosovë. Çështjet e prodhimit, konsumit të ushqimit, tregtisë së ushqimit, bujqësisë dhe blegtorisë si mjete jetese, avancimi i barazisë për popullatat e marginalizuara, sfidat mjedisore dhe qëndrueshmëria e ndërtimit, janë të gjitha temat që rezonojnë fuqishëm në Kosovë. Prodhimi dhe konsumi i ushqimit të mjaftueshëm, të përballueshëm dhe me vlera ushqyese për të gjithë është jetik, duke ruajtur gjithashtu burimet natyrore dhe ekosistemet nga të cilat varet sistemi ushqimor. Sistemi ushqimor i Kosovës është nën presionin në rritje për t'iu përgjigjur sfidave të shumta dhe komplekse. Këtu përfshihet:

- Ndikimi i çmimit të ushqimit në sigurinë e ushqimit dhe në mirëqenie
- Varësia e lartë në importet ushqimore
- Hisja e lartë e ekonomisë bujqësore dhe varësia në bujqësi për mbijetesë
- Gratë përbëjnë pothuajse 50% të popullsisë së Kosovës, por vetëm 5% e tyre janë pronare të tokave bujqësore.
- Një kornizë ligjore dhe institucionale me mundësi të forcimit të zbatimit
- Një agjendë e papërfunduar për ta përkrahur financimin e bujqësisë për bizneset e vogla
- Mungesa e një sistemi të unifikuar dhe gjithëpërfshirës për t'u marrë me menaxhimin e mbetjeve urbane
- Mungesa e statistikave dhe e provave në dispozicion
- Vëmendje e kufizuar në çështjet e të ushqyerit
- Fragmentimi i madh i tokave
- Nevoja e njohur për vëmendje më të madhe për bujqësinë e qëndrueshme dhe prodhimin e ushqimit
- Potenciali për ta zgjeruar bujqësinë dhe bizneset lokale
- Mundësitë për të përfshirë sektorin privat në menaxhimin e mbeturinave

Pandemia COVID-19 e ka theksuar nevojën për sisteme të forta dhe funksionale ushqimore për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive brishtësive dhe tronditjeve. Subvencionet e qeverisë së Kosovës për sektorin e bujqësisë ishin rreth 1% e GDP-së në vitin 2020, duke përfshirë masat e planifikuara të rimëkëmbjes. Në nivel të Ballkanit Perëndimor, bujqësia ishte sektori i tretë më i prekur në ekonomi (pas shërbimeve dhe industrisë). Në të njëjtën kohë, pandemia COVID-19 dha një mundësi për të ndërtuar plane të rimëkëmbjes që ndryshojnë trendet aktuale dhe ndryshojnë modelet e konsumit dhe prodhimit drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.

Lëvizja drejt sistemeve ushqimore më të qëndrueshme është kritike. Konsumi dhe prodhimi i qëndrueshëm synon që të bëhet më shumë dhe më mirë me më pak. Por ka të bëjë gjithashtu me shkëputjen e rritjes ekonomike nga degradimi i mjedisit, rritjen e efikasitetit të resurseve dhe promovimin e stileve të qëndrueshme të jetesës. Kështu, sistemi i qëndrueshëm i ushqimit në Kosovë mund të luajë një rol kritik në zgjidhjen e çështjeve të sigurisë ushqimore, zbutjes së varfërisë dhe ushqimit adekuat, dhe mund të kontribuojë në ndërtimin e reziliencës në komunitet. Kërkohe vëmendje urgjente për t'i adresuar sfidat ekzistuese, si dhe kërkesat e reja dhe në zhvillim për sistemet tona ushqimore.

Brenda kësaj kornize, Dialogu ynë eksploroj mënyra dhe zgjidhje për ta rritur vetëdijen, si dhe për t'i katalizuar veprimet e drejtuara nga vendasit rreth temave të (1) Prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit (2) Konsumit të qëndrueshëm të ushqimit (3) Përdorimit qarkor të burimeve ushqimore

PISTAT E VEPRIMIT

- ✓ Pista e veprimit 1: Siguroni qasje në ushqime të sigurta dhe ushqyese për të gjithë
- ✓ Pista e veprimit 2: Kalimi në modele të qëndrueshme të konsumit
- ✓ Pista e veprimit 3: Nxitja e prodhimit pozitiv ndaj natyrës
- ✓ Pista e veprimit 4: Avancimi i jetesës së barabartë
- ✓ Pista e veprimit 5: Ndërtoni reziliencë ndaj brishtësive, tronditjeve dhe stresit

FJALËT KYÇE

- ✓ Financat
- ✓ Inovacioni
- ✓ Të drejtat e njeriut
- ✓ Fuqizimi i Grave dhe Rinisë
- ✓ Politikat
- ✓ Të dhënat & Provat
- ✓ Qeverisja
- ✓ Kompromiset
- ✓ Mjedisi dhe Klima

GJETJET KRYESORE

Në përgjithësi, pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e qasjes në ushqime të shëndetshme, ushqyese, të sigurta dhe të përballueshme si një "domosdoshmëri" për tërë popullin e Kosovës dhe gjeneratat e ardhshme, por edhe si pjesë e pandashme e përpjekjeve të Kosovës për të arritur progres në zhvillimin afatgjatë dhe prosperitetin e përbashkët. Si prodhuesit ashtu edhe konsumatorët e ushqimit mbajnë përgjegjësinë për të krijuar një sistem ushqimor më të barabartë në Kosovë dhe ekziston nevoja për të harmonizuar më mirë interesat dhe shtytësit që qëndrojnë pas vendimeve të tyre për konsumin dhe prodhimin e ushqimit, me tre komponentët e "jetesës-ushqyerjes-mjedisit". Për më tepër, pjesëmarrësit theksuan se si kombinimi i parimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore janë kyçe për adresimin e çështjeve të përfshirjes dhe përballueshmërisë rreth temës së qasjes në ushqim të shëndetshëm, ushqyese dhe të sigurt në Kosovë.

Në mënyrë që sistemi ushqimor i Kosovës të jetë më gjithëpërfshirës, i qëndrueshëm dhe i shëndetshëm, nevojiten përpjekje të mëtejshme për 1) krijimin e kombinimit të duhur të stimuljeve për bizneset dhe prodhuesit që të ndryshojnë sjelljet dhe modelet e tyre, 2) shqyrtimin e kornizës institucionale, legjislativë dhe rregullative për integrimin më të mirë të koncepteve të mbrojtjes së mjedisit dhe klimës 3) zvogëlimin e rreziqeve (qasja, përballueshmëria, të ardhurat) për më të margjinalizuarit brenda sistemit dhe 4) përkrahjen e mundësive për të fituar të ardhura në zinxhirët e vlerave ushqimore. Përveç kësaj, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë forcimit të barazisë gjinore në sistemin ushqimor të Kosovës, duke përfshirë nevojën për të ofruar më shumë mundësi për gratë në zinxhirët e vlerave bujqësore, si qasja në tokë, punë, financa dhe vendimmarrje.

Në lidhje me Samitin e ardhshëm të Sistemeve Ushqimore, pjesëmarrësit presin me padurim të vazhdojnë bisedën rreth ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm ushqimor në Kosovë dhe të punojnë së bashku për të transformuar një mori idesh, dëshmish dhe rekomandimesh në zgjidhje konkrete dhe praktike për të avancuar jetesën e barabartë në sistemin ushqimor të Kosovës. Do të bëhen përpjekje për t'i integruar më mirë këto në iniciativat e vazhdueshme që tashmë po zhvillohen në mbarë Kosovën. Për të përmendur disa, këto përfshijnë: iniciativat për të reduktuar mbeturinat ushqimore (p.sh. Sfida e mbeturinave ushqimore nga UNDP), planet e komunave për të përmirësuar jetesën lokale, përpjekjet e OShC-ve për të promovuar një kulturë të riciklimit dhe përdorim më të përgjegjshëm të resurseve.

PISTAT E VEPRIMIT

- ✓ Pista e veprimit 1: Siguroni qasje në ushqime të sigurta dhe ushqyese për të gjithë
- ✓ Pista e veprimit 2: Kalimi në modele të qëndrueshme të konsumit
- ✓ Pista e veprimit 3: Nxitja e prodhimit pozitiv ndaj natyrës
- ✓ Pista e veprimit 4: Avancimi i jetesës së barabartë
- ✓ Pista e veprimit 5: Ndërtoni reziliencë ndaj brishtësive, tronditjeve dhe stresit

FJALËT KYÇE

- ✓ Financat
- ✓ Inovacioni
- ✓ Të drejtat e njeriut
- ✓ Fuqizimi i Grave dhe Rinisë
- ✓ Politikat
- ✓ Të dhënat & Provat
- ✓ Qeverisja
- ✓ Kompromiset
- ✓ Mjedi dhe Klima

REZULTATET PËR ÇDO TEMË - 1/3

1/3 Pyetje për diskutim #1: Prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit

1. Forcimi i rolit të grave jo vetëm në përpunimin e ushqimit, por në menaxhimin e kompanive të përpunimit të ushqimit
2. Roli dhe partneritetet ndërmjet sektorit privat DHE qeverisë, partnerëve lokal, fermerëve, akademisë, arsimit etj. për të kuptuar interesat dhe nevojat e të gjithë hisedarëve së bashku me sistemin ushqimor.
3. Përkrahja e integritet më të thellë në zinxhirët rajonal të vlerës agro-ushqimore, veçanërisht në ata sektorë (p.sh. frutat, ullinjtë, etj.) ku Kosova gëzon disi një avantazh konkurrues.
4. Investimi në aftësi për të rritur njohuritë financiare në fermat e vogla/familjare (veçanërisht te gratë)
5. Përmirësimi i reziliencës së fermerëve duke investuar në nevojat adaptive dhe zbutëse ndaj ndryshimeve klimatike
6. Promovimi i zhvillimit të produktit vendor – shërbimet këshilluese bujqësore dhe sipërmarrjet tjera rurale/këshillimore p.sh. brendimi, njohja e emrit dhe identifikimi me rajonin gjeografik
7. Rëndësia e bujqësisë ekologjike dhe biologjike në lidhje me përdorimin e pesticideve dhe rregulloret shoqëruese për të siguruar përdorimin e sigurt dhe adekuat të tyre. Lidhjet me bujqësinë organike, turizmin dhe shëndetin e konsumatorëve.
8. Përdorimi i resurseve natyrore, veçanërisht ato që lidhen me degradimin e tokës, erozionin, pyjet dhe kullotat, si një nga burimet e rëndësishme natyrore, që kontribuojnë në zhvillimin e turizmit, mbrojtjen nga erozioni, por edhe kontribuojnë në aspektin ekonomik dhe ekonominë e gjelbër.
9. Reduktimi i barrierave për fermerët e vegjël dhe grupet tjera të veçanta në bujqësi nëpërmjet ofrimit të mikrokredive dhe mekanizmave financues më të qasshme dhe të përballueshme.
10. Kushtojni vëmendje pasigurisë ushqimore që po shfaqet – amvisëritë e prirura ndaj pasigurisë ushqimore – rjetave fleksibile të sigurisë në nivel komunal
11. Promovimi i zhvillimit të zinxhirit të vlerës që përfshinë prodhimin e ushqimit të lidhur me turizmin, bletarinë, produktet lokale (p.sh. specat dhe barishtet aromatike) – ndër të tjera për fuqizimin ekonomik të grave rurale
12. Nevojitet zbatim i duhur i legjisllacionit dhe mekanizma më të mirë monitorues për tërë kornizën legjislative të sistemit ushqimor.
13. Fermerët dhe prodhuesit duhet të jenë më të vetëdijshëm për rëndësinë e shërbimeve të konsulencës profesionale dhe programeve të trajnimit të ofruara në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre për praktikatat e qëndrueshme të prodhimit.
14. Duhet të rriten kapacitetet e inspektoratit në institucionet e nivelit qendror dhe lokal për të pasur më shumë kontroll të cilësisë së artikujve ushqimorë. Për më tepër, duhet të ketë koordinim më të mirë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe drejtorive komunale të bujqësisë.
15. Duhet të ketë më shumë investime në sistemet e ujitjes dhe pastrimit të burimeve ujore.
16. Institucionet e nivelit qendror duhet të ndërthurin politikatat për ta promovuar bujqësinë tek të rinjtë dhe për ta dekurajuar migrimin.

PISTAT E VEPRIMIT

- ✓ Pista e veprimit 1: Siguroni qasje në ushqime të sigurta dhe ushqyese për të gjithë
- ✓ Pista e veprimit 2: Kalimi në modele të qëndrueshme të konsumit
- ✓ Pista e veprimit 3: Nxitja e prodhimit pozitiv ndaj natyrës
- ✓ Pista e veprimit 4: Avancimi i jetesës së barabartë
- ✓ Pista e veprimit 5: Ndërtoni reziliencë ndaj brishtësive, tronditjeve dhe stresit

FJALËT KYÇE

- ✓ Financat
- ✓ Inovacioni
- ✓ Të drejtat e njeriut
- ✓ Fuqizimi i Grave dhe Rinisë
- ✓ Politikat
- ✓ Të dhënat & Provat
- ✓ Qeverisja
- ✓ Kompromiset
- ✓ Mjedisi dhe Klima

2/3 Pyetje për diskutim #2: Konsumi i qëndrueshëm i ushqimit

Diskutimi i dytë u fokusua në zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe konsumin e ushqimit si një shteg për të siguruar jetesë më të mirë të sistemit ushqimor, duke cituar shembuj dhe zgjidhje praktike nga përvojat dhe njohuritë e pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit ranë dakord se përfshirja dhe barazia, bazuar në një qasje me njerëzit në qendër, është çelësi për sigurimin e një jetese më të mirë ushqimore në viset rurale dhe urbane për grupet e cenueshme, përfshirë gratë, të rinjtë, komunitetet jo-shumicë dhe komunitetet tjera me sisteme të ndryshme jetese. Disa pjesëmarrës vunë në dukje se zhvillimi i aftësive, duke përfshirë aftësitë digjitale që lidhen me përdorimin e TIK-ut dhe mjeteve moderne online, janë mundësues të rëndësishëm për transformimin e fermerëve në sipërmarrës konkurrues. Kjo do të siguronte fuqizim më të mirë ekonomik të grave dhe do të joshte më shumë punëtorë të rinj.

Për sa i përket ndikimit të pandemisë COVID-19 në jetesën e sistemit ushqimor në Kosovë, pjesëmarrësit vunë në dukje se ndikimi i menjëhershëm i pandemisë u ndje përmes dobësisë të kërkesës për ushqim në Kosovë dhe mbylljes së shumë bizneseve, si gastronomia dhe hotelet. Prandaj, ekziston nevoja për të forcuar reziliencën në sistemin ushqimor të Kosovës, për të mundësuar "shitjen e drejtpërdrejtë" nga prodhuesit e vegjël bujqësorë konsumatorëve lokal, gjë që mundëson shumë fermerëve dhe lojtarëve të vegjël të vazhdojnë bizneset e tyre dhe të promovojnë posaçërisht pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve si ndërmjetësues digjital të zinxhirëve të vlerave ushqimore. Nga ana tjetër, kjo mund të ndihmojë në uljen e problemeve të mbeturinave ushqimore, duke dhuruar ushqimin e tepërt nga prodhuesit atyre që kanë nevojë. Në këtë drejtim, platformat digjitale kanë rol më të madh për të luajtur, për shembull për ta optimizuar prodhimin dhe për të minimizuar mbetjet ushqimore.

Në ndryshimet e fundit në bazën e kërkesës për ushqim bujqësor, disa pjesëmarrës vunë re gjithashtu prirjen në rritje në dietat e njerëzve drejt më shumë ushqimeve me bazë shtazore (p.sh. mishi) dhe ushqimi i përpunuar, i cili kërkon përshtatje në modelet e prodhimit bujqësor, ku këtij të fundit i mungon e njëjta sasi lëndësh ushqyese.

U ngritën pika shtesë për rëndësinë që institucionet e Kosovës të synojnë subvencionet qeveritare për më të cenuarit për të maksimizuar përfshirjen dhe për të siguruar jetesë të barabartë. U nënvizua gjithashtu rëndësia e partneriteteve me bizneset, të cilat do të mundësonin bashkëpunimin multidisiplinar në mes të fermerëve, OJQ-ve, qeverive dhe pronarëve të restoranteve për të hartuar projekte që mund të lidhin fermerët e vegjël (veçanërisht ata nga viset rurale) me zonat e mëdha tregtare dhe qendrat urbane.

Rekomandimet plotësuese përfshijnë:

- Analiza, mbledhja e të dhënave dhe raportimi i rregullt duhet të kryhen për shportën e ushqimit të konsumatorit në mënyrë që të merren njohuri për vlerat bazë ushqyese dhe të sigurohen politika të bazuara në dëshmi që e përkrahin sistemin e qëndrueshëm ushqimor.
- Përfundimi i digjitalizimit të parcelave të tokës dhe përmirësimi i kategorizimit të tokës për të adresuar sfidat aktuale për shkak të fragmentimit dhe madhësisë së vogël të parcelave të tokës.
- Krijimi i skemave përkrahëse për sistemet ngadalta të ushqimit, të cilat do të inkurajonin prodhuesit vendas në përvetësimin e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit, në ekonomizimin e zonës lokale dhe inkurajimin e qytetarëve drejt konsumit të artikujve ushqimorë të prodhuar në vend.
- Përkrahja e inovacionit në bujqësinë urbane përmes fondeve dhe programeve të dedikuara, të cilat do të kontribuonin në kohezion më të lartë social në mes të anëtarëve të komunitetit, promovimin e produkteve të gjelbra me intensitet të ulët karboni dhe përfshirjen më të mirë të të gjithë anëtarëve të shoqërisë për të mos lënë askënd pas.

PISTAT E VEPRIMIT

- ✓ Pista e veprimit 1: Siguroni qasje në ushqime të sigurta dhe ushqyese për të gjithë
- ✓ Pista e veprimit 2: Kalimi në modele të qëndrueshme të konsumit
- Pista e veprimit 3: Nxitja e prodhimit pozitiv ndaj natyrës
- Pista e veprimit 4: Avancimi i jetesës së barabartë
- Pista e veprimit 5: Ndërtoni reziliencë ndaj brishtësive, tronditjeve dhe stresit

FJALËT KYÇE

- ✓ Financat
- ✓ Inovacioni
- Të drejtat e njeriut
- Fuqizimi i Grave dhe Rinisë
- ✓ Politikat
- ✓ Të dhënat & Provat
- ✓ Qeverisja
- Kompromiset
- ✓ Mjedisi dhe Klima

REZULTATET PËR ÇDO TEMË - 3/3

3/3 Pyetje për diskutim #3: Shfrytëzimi qarkor i burimeve natyrore

- Integrimi i ndikimeve mjedisore, ekonomike dhe sociale si pjesë e vlerësimeve të përgjithshme (vlerësimet e kosto-benefite, vlerësimi i ndikimit etj.) në lidhje me politikat, vendimet dhe investimet e qeverive dhe sektorit privat për ushqimin dhe bujqësinë
- Integrimi i çështjeve lidhur me humbjen dhe mbeturinat e ushqimit si element thelbësor i sistemit arsimor të Kosovës dhe kurrikulave për të gjithë (p.sh. komunat, shërbyesit publik, bizneset etj.), duke përfshirë konceptet dhe parimet kryesore për të analizuar se ku kemi humbje, në cilat nivele dhe pse, por edhe si t'i zvogëloni ato
- Forcimi i trajnimeve/kurrikulave profesionale dhe arsimore përmes programeve të synuara për edukimin e brezave të rinj mbi nevojën për të kuptuar statusin dhe sfidat e sistemit
- Edukimi i konsumatorëve për të bërë zgjedhje të shëndetshme për llojin dhe sasinë e ushqimit që konsumojnë
- Nevoja për të zbuluar, analizuar dhe raportuar më mirë përdorimin e pesticideve dhe kimikateve në prodhimin bujqësor, nëpërmjet një sistemi më të mirë të kontrollit të ushqimit që është në gjendje të monitorojë procedurat standarde të funksionimit për kontrollin e ushqimit për njerëz dhe ushqimit të kafshëve në të gjitha fazat
- Nevoja për certifikim dhe gjurmueshmëri në sistemet e prodhimit, veçanërisht të lidhura me produktet organike dhe lokale, për ta kuptuar origjinën dhe përpunimin e produkteve bujqësore përgjatë zinxhirit të vlerës dhe për t'ua komunikuar atë konsumatorëve përmes etiketimit të duhur, duke rritur kështu besimin e konsumatorit.
- Shfrytëzimi i përparësisë së potencialit të agroturizmit në Kosovë, si një shembull kryesor i sektorëve (të tjerat përfshijnë eko-turizmin) që kanë kaluar nëpër transformime për të promovuar zhvendosje drejt mënyrave më të qëndrueshme të të bërit biznes, të cilat vendosin qëndrueshmërinë dhe mjedisin në thelb të modelit të tyre.
- Agro-ekologjia si koncept duhet të integrohet brenda kornizës së politikave dhe kurrikulave arsimore.
- Nevoja për të analizuar kostot si dhe benefitet e një diete të shëndetshme, në mënyrë të tillë që të përgatiten paketa të politikave për përkrahje financiare të udhëhequra nga prova të shëndosha dhe të përditësuara dhe një vlerësim i fortë i alternativave.
- Forcimi i provave dhe vlerësimeve të disponueshme për të vlerësuar lidhjet dhe ndikimin e prodhimit të ushqimit dhe bujqësisë në mjedis (p.sh. shpyllëzimi) dhe kontributin në emetimet e gazit serrë (GHG)
- Parimi "Ndotësi paguan" duhet të integrohet thellësisht në kornizën e politikave që mbulon politikat ndërinstitucionale. Të hyrat financiare që rrjedhin nga politikat parimore "Ndotësi paguan" duhet të trajtohen si të dedikuara për financimin e programeve që promovojnë në mënyrë specifike mbrojtjen e mjedisit dhe sistemin e qëndrueshëm të ushqimit.
- Shfrytëzimi i fuqisë së inovacionit dhe teknologjive digjitale për ta bërë kalimin e prodhimit bujqësor nga sistemet me input intensiv në sistemet me njohuri intensive dhe zgjerim efektiv të mundësive për punësim.

PISTAT E VEPRIMIT

- ✓ Pista e veprimit 1: Siguroni qasje në ushqime të sigurta dhe ushqyese për të gjithë
- Pista e veprimit 2: Kalimi në modele të qëndrueshme të konsumit
- ✓ Pista e veprimit 3: Nxitja e prodhimit pozitiv ndaj natyrës
- Pista e veprimit 4: Avancimi i jetesës së barabartë
- ✓ Pista e veprimit 5: Ndërtoni reziliencë ndaj brishtësive, tronditjeve dhe stresit

FJALËT KYÇE

- ✓ Financat
- ✓ Inovacioni
- ✓ Të drejtat e njeriut
- ✓ Fuqizimi i Grave dhe Rinisë
- ✓ Politikat
- Të dhënat & Provat
- ✓ Qeverisja
- Kompromiset
- ✓ Mjedi dhe Klima

Në të gjitha grupet, kishte një larmi të mendimeve dhe pikëpamjeve. Megjithatë, të gjitha diskutimet u zhvilluan në frymën e respektit të ndërsjellë dhe duke vlerësuar opinione të ndryshme. Në fushën e prodhimit të qëndrueshëm, ka pasur mendime të ndryshme nëse promovimi i ushqimit të shëndetshëm dhe atij organik duhet të bëhet përmes mekanizmave shtetërorë si stimujt fiskalë, taksat etj., apo përmes instrumenteve të ekonomisë së tregut, pra përmes promovimit të kërkesës nga vetëdijësimi dhe rritja e fuqisë blerëse në përgjithësi.

Të njëjtat divergjenca janë parë në pjesën e konsumit të qëndrueshëm dhe ekonomisë qarkore. Pyetja se cili duhet të jetë roli i Qeverisë në promovimin e prodhimit të qëndrueshëm është përgjigjur në forma të ndryshme nga përfaqësues të sektorëve të ndryshëm. Ndërsa fermerët i shihnin subvencionet si mënyrën më të mirë, industria e përpunimit të ushqimit dhe politikëbërësit i konsideruan mekanizmat tjerë fiskalë dhe indirektë si njësoj të rëndësishëm. Ka pasur mendime të ndryshme, por edhe plotësuese lidhur me rolin e vetëdijësimit të qytetarëve. Kishte mendime se duhet të përfshihet shoqata e mjekëve për ta inkurajuar konsumin e qëndrueshëm duke marrë parasysh edhe faktin se siguria ushqimore nuk duhet të ngatërrohet me cilësinë e ushqimit dhe se shteti mund të punojë në vetëdijësimin e qytetarëve për cilësinë e ushqimit por që kërkesa për ushqimin e prodhuar në mënyrë të qëndrueshme duhet të vijë nga poshtë-lart.

PISTAT E VEPRIMIT

- ✓ Pista e veprimit 1: Siguroni qasje në ushqime të sigurta dhe ushqyese për të gjithë
- ✓ Pista e veprimit 2: Kalimi në modele të qëndrueshme të konsumit
- ✓ Pista e veprimit 3: Nxitja e prodhimit pozitiv ndaj natyrës
- ✓ Pista e veprimit 4: Avancimi i jetesës së barabartë
- ✓ Pista e veprimit 5: Ndërtoni reziliencë ndaj brishtësive, tronditjeve dhe stresit

FJALËT KYÇE

- ✓ Financat
- Inovacioni
- Të drejtat e njeriut
- Fuqizimi i Grave dhe Rinisë
- ✓ Politikat
- Të dhënat & Provat
- ✓ Qeverisja
- Kompromiset
- Mjedisi dhe Klima

BASHKËNGJITJET DHE LINKAT RELEVANT

LINKAT RELEVANT

- Fjalimet hapëse të Dialogut të Pavarur të Kosovës
<https://www.facebook.com/252697314788253/videos/1380726692320681>
- Fjalimet përmbyllëse të Dialogut të Pavarur të Kosovës
<https://fb.watch/6WwjUkOkzt/>
- Intervistë e organizuesit në Radio-Televizionin Publik të Kosovës
<https://fb.watch/6WwnpzwPUc/>
- Kumtesë për shtyp: Organizimi nga INDEP dhe Kombet e Bashkuara do të sigurojnë se zërat e Kosovës dëgjohe në Samitin Global për të ardhmen e ushqimit
<https://indep.info/en/press-release-indep-and-united-nations-event-will-ensure-kosovo-voices-heard-at-global-summit-on-the-future-of-food/>

